STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 28 shtator 2013

**GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE PROGRAMI I RIMEKEMBJES SE STREHIMIT DO TE KOMPENSOJE PRONARET E SHTEPIVE PER RIPARIME TE DEMTIMEVE TE SHKAKTUARA NGA STUHITE IRENE (IRENE) LI (LEE) DHE SENDI (SANDY)**

***Programi do të mbulojë riparime të dëmtimeve për shkak të 'lëvizjes së tokës' që nuk mbulohen nga programi kombëtar i sigurimit të përmbytjeve***

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Programi i Rimëkëmbjes së Strehimit i Shtetit të Nju Jorkut (New York State) do të kompensojë plotësisht pronarët e shtëpive të prekur nga uragani Irene (Irene), stuhia tropikale Li dhe super stuhia Sendi (Sandy) për kostot e riparimeve të dëmtimit të shtëpive të tyre për shkak të 'lëvizjes së tokës.' Sipas rregulloreve ekzistuese të Programit Kombëtar të Sigurimit të Përmbytjeve (NFIP) të FEMA-s, dëmtimet e shkaktuara nga lëvizja e dheut ose e tokës – edhe nëse lëvizja është si rezultat i përmbytjes – nuk kualifikohen për t'u mbuluar nga sigurimi. Në krahasim, dëmtimet fizike të një ndërtese të shkaktuara drejtpërdrejt nga ujrat e përmbytjes mbulohen sipas NFIP-së. Si rezulat i kësaj të mete në mbulim, qindra pronarëve të shtëpive të prekur anembanë shtetit iu janë mohuar kërkesat e tyre për NFIP, duke lënë shumë pa asnjë vend ku të jetojnë dhe pa burime për të rindërtuar.

"Gjatë disa viteve të fundit, përjetuam tre stuhi që ndodhin një herë në shekull që shkaktuan një nivel të pashembullt shkatërrimi në komunitetet anembanë shtetit," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ndërsa kemi bërë mjaft përparim në rimëkëmbjen nga Irena (Irene), Li (Lee) dhe Sendi (Sandy), shumë banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) ende kanë mbetur pa një vend për t'a quajtur shtëpi dhe me burime të kufizuara për të rindërtuar për shkak të rregulloreve të Programit Kombëtar të Sigurimit të Përmbytjeve (NFIP), që deklarojnë se shtëpitë e dëmtuara nga 'lëvizja e tokës' nuk mbulohen. Megjithatë kjo thjesht nuk ka kuptim që disa banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) që u goditën po aq rëndë nga të njëjtat stuhi si të tjerët nuk mund të kompensohen për humbjet e tyre. Kjo është se pse Shteti po futet për të rregulluar këtë të metë të padrejtë në mbulimin nga sigurimi. Sipas Programit tonë të Rimëkëmbjes së Strehimit, pronarët e shtëpive do të kompensohen plotësisht për të gjitha riparimet e dëmtimeve. Jemi të gëzuar që të japim këtë ndihmë në mënyrë që të gjithë banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të mund të shkojnë përpara në rrugën drejt një rimëkëmbje të plotë."

"Shumë banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) kishin shpresa se do të mbuloheshin meqënse kishin blerë

sigurime nga përmbytja," tha Drejtori i Zyrës së Guvernatorit për Rimëkëmbjen nga Stuhia, Seth Diamond. "Megjithatë, nuk kishin dijeni për këtë rregull të NFIP-së në lidhje me lëvizjet e tokës. Si rezultat, këta pronarë të shtëpive nuk morën ndihmën që po kërkonin dhe shumë që nuk patën burimet për të rindërtuar vetë ende nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre. Tani përkundrazi, këta banorë do të kualifikohen për të marë fonde nëpërmjet programit të rindërtimit të shtëpive të Shtetit (State) dhe kostot e tyre për rindërtimet që kualifikohen do të mbulohen."

Shteti (State) do të vazhdojë të zhvillojë takime me pronarët e shtëpive për të siguruar se ata që janë të interesuar mund të bëjnë kërkesë për ndihmë. Përveç kësaj, Zyra e Rimëkëmbjes nga Stuhia do të sigurojë ndihmë teknike për komunitetet sipas Programit të Rindërtimit të Ngritjes së Komuniteteve të Nju Jorkut (New York) për të vlerësuar dhe përcaktuar nëse masat vendore të qëndrueshmërisë mund të ndihmojnë në kufizimin e lëvizjeve të tokës. Për më shumë informacion, telefononi në 1-855-697-7263 ose vizitoni www.stormrecovery.ny.gov.

Guvernatori Kuomo (Cuomo) krijoi Zyrën e Rimëkëmbjes nga Stuhia në qershor 2013 për të centralizuar përpjekjet e rimëkëmbjes dhe rindërtimit në bashkitë e prekura nga stuhia anëmbanë Shtetit (State). Në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësit vendorë dhe të komunitetit në këto zona, Zyra është duke punuar për t'iu përgjigjur nevojave më urgjente të rindërtimit të komuniteteve dhe gjithashtu për të identifikuar zgjidhjet afat-gjata dhe novatore për të përforcuar sistemet e infrastrukturës dhe të rëndësishme të Shtetit (State) për të ardhmen. Programe të Rimëkëmbjes nga Stuhia përfshijnë programin e Rikrijimit të Shtëpive të Zgjuara të NY, që u siguron pronarëve të shtëpive ndihmë për riparime/ndreqje, lehtësim e ngritje dhe blerje të shtëpive dhe programin e Biznesit të Vogël, që u siguron bizneseve të vogla financime deri në $50,000 ose më shumë, si dhe hua me interes të ulët.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418